



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
TEATRI KOMBËTAR I OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR  
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE  
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 1224 Prot

Tiranë, më 20/11 /2023

N J O F T I M

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor, në mbështetje të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i RSH”, i ndryshuar; Ligjit Nr.10 352, datë 18.11.2010 “Për Artin dhe Kulturën” i ndryshuar neni 9 pika 1, gërma ç; neni 13 e në vijim; VKM-së Nr. 176, datë 29.03.2006, “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”; Urdhër të Kryeministrit nr 140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së TKOBAP-së”; Statutit të Institucionit të TKOBAP miratuar me urdhër të Ministrit të Ministrisë së Kulturës nr 166 datë 27.04.2015 neni 15 gërma c; Rregullores së Brendshme “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Institucionit të TKOBAP-së me nr.1850 prot datë 25.07.2014; të shpallë 1 (një) vend vakant për pozicionin e punës:

❖ **Solist/e e Parë Baleti - pranë Drejtorisë së Baletit**

Për ti dhënë më shumë kohë shpërndarjes së informacionit për vende të lira pune në sektorët artistikë e për rrjedhojë për ti krijuar mundësi pjesmarrjes më të madhe në numër të konkurrentëve TKOBAP nxjerrë njoftimin e saj 30 ditë përpara.

Audicioni për këtë vend vakant do të mbahet në ambientet e brendshme të TKOBAP-së (salla e baletit) me adresë: “Sheshi Skënderbej” Tiranë, në datën **12/01/2024, ora 14:00**.

Të gjithë artistët që janë të interesuar për tju nënshtruar audicionimit, duhet të dorëzojnë pranë zyrës së protokollit të Institucionit të TKOBAP-së deri në datën **05/01/2024 ora 14:00** dokumentacionin e kërkuar si më poshtë:

**Kriteret e përgjithshme (dokumentacioni):**

1. Të ketë kryer studimet në shkollën e baletit ose ekuivalentin e saj brenda ose jashtë vendit;
2. Fotokopje të diplomës dhe listë notash të noterizuar në shtetin përkatës;
3. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) ose një dokument ekuivalent me të;
4. Fotokopje e dokumentit të identitetit të vlefshëm;
5. Vërtetim të gjendjes shëndetësore, ose një dokument ekuivalent me të;
6. Vërtetim të gjendjes gjyqësore, ose një dokument ekuivalent me të;
7. Një kopje të Curriculum Vitae bashkëngjitur me Foto, (veprimtaria në vite e çertifikuar, mastër class, Work shop, programe koncertesh, recitalesh, shfaqje të ndryshme, si dhe të dhëna të tjera që plotësojnë figurën artistike, experience pune për vendin që aplikon, tituj artistik etj). Dokumentacionin e nevojshëm për të vërtetuar këtë kriter;
8. Preferohet të ketë njohuri minimalisht të gjuhës angleze dhe italiane.

Të ketë minimalisht 2 (dy) vjet eksperiencë si balerin në teatër ose në kompani profesionale baleti.

**Kandidati/ja duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:**

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejon të kryejë detyrën e provuar me dokumentacionin përkatës;
4. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
5. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje e certifikuar nga shteti i tij;
6. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

**Program i detyruar:**

- Ushtrimet e baletit (të gjithë balerinët konkurent, shtetas shqiptarë ose të huaj);
- Dy variacione nga repertori klasik botëror (me karakter të ndryshëm nga njeri-tjetri);
- Adagio Repertori i cili do të kërkohet nga komisioni;
- Improvizim sipas kërkesës së komisionit.

Informacion: Kohëzgjatja e ushtrimeve të baletit: 1 orë e 15 minuta.

10 minuta pushim, konkurentët përgatiten për pikën 2.

Të gjithë konkurentët do të performojnë variacionin e 1-rë dhe më pas të 2- in.

Koha e përgatitjes së Adagio-s nga konkurentët do të jetë 30 minuta.

Shënim Konkurenët do të debutojnë me njëri-tjetrin por për çdo eventualitet një çift nga trupa e baletit do të jetë në dispozicion për pjesmarrësit.

**Komisioni ruan të drejtën që të dëgjojë të gjithë ose një pjesë të programit të konkursit.**

Për sqarime të mëtejshme, ju lutem mos hezitoni të na kontaktoni në adresën:

[sekretaria@tkob.gov.al](mailto:sekretaria@tkob.gov.al) [Alisa.Gjoni@tkob.gov.al](mailto:Alisa.Gjoni@tkob.gov.al)

**MIRATOI**

**DREJTORE E PËRGJITHSHME**

**Abigeila VOSHTINA**

